



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_ . 2021

**VENDIM**

**Nr. 584, datë 16.12.2021**

**PËR**

**CAKTIMIN E GJYQTARIT TË SKEMËS SË DELEGIMIT  
ZNJ. IGERTA HYSI, PËR GJYKIMIN E NJË ÇËSHTJEJE GJYQËSORE  
NË GJYKATËN E POSAÇME TË APELIT PËR KORRUPSIONIN  
DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a”, të pikës 4 dhe pikën 7, të nenit 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 13, të Vendimit të tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dërguar me Shkresën nr. 495/1 prot., datë 07.12.2021, protokolluar në Këshill me aktin nr. 5648 prot., datë 13.12.2021, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe mbas shortit të hedhur,

**VENDOSI:**

1. Gjyqtari i skemës së delegimit znj. Igerta Hysi caktohet për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar çështjen penale me të pandehur: {...} dhe {...}; Akuza: “Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal”.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës Igerta Hysi, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**